

TERMA REFERENCE (ToR)

Pozicioni: Logoped

Qendra Sociale Multifunkionale e Specializuar për Personat me Aftësi të Kufizuara

Organizata: Shoqata “Ndhmoni Jetën”

Vendndodhja: Fshati Prush, Njësia Administrative Vaqarr, Tiranë

Kohëzgjatja e kontratës: 12 muaj (me mundësi rinovimi)

Forma e punësimit: Me kohë të plotë

1. Hyrje – Qëllimi i shërbimit

Qendra Sociale Multifunkionale e Specializuar për Personat me Aftësi të Kufizuara, e administruar nga Shoqata “Ndhmoni Jetën”, ka për qëllim ofrimin e shërbimeve të integruara sociale, dhe mbështetëse për persona me aftësi të kufizuara intelektuale dhe me çrregullim të spektrit të autizmit, si dhe për familjet dhe kujdestarët e tyre. Qendra synon të përmirësojë cilësinë e jetës së përfituesve, të rrisë pavarësinë, autonominë dhe aftësitë funksionale të tyre, si dhe të promovojë përfshirjen aktive sociale dhe komunitare, në përputhje me parimet e jetesës së pavarur, barazisë, mosdiskriminimit dhe respektimit të dinjitetit njerëzor.

2. Përshkrimi i rolit

Logopedi është pjesë e ekipit multidisciplinar të Qendrës dhe ka rol thelbësor në vlerësimin, trajtimin dhe përmirësimin e aftësive të komunikimit, gjuhës, të folurit dhe ndërveprimit social të fëmijëve dhe të rinjve përfitues. Roli i Logopedit konsiston në ofrimin e ndërhyrjeve të specializuara logopedike individuale dhe në grup, hartimin dhe zbatimin e planeve individuale të terapisë së të folurit dhe gjuhës, si dhe në mbështetjen e familjeve për të vazhduar ndërhyrjen në mjedisin familjar.

3. Detyrat dhe përgjegjësitë e përgjithshme

Punonjësi/ja do të:

- Kryejë vlerësime fillestare dhe periodike të komunikimit, gjuhës dhe të folurit për përfituesit;
- Hartojë dhe zbatojë plane individuale të ndërhyrjes logopedike, në bashkëpunim me ekipin multidisciplinar;
- Ofrojë seanca terapie logopedike individuale dhe në grup për fëmijët dhe të rinjtë;
- Mbështesë zhvillimin e aftësive të komunikimit verbal dhe joverbal dhe ndërveprimit social;
- Ofrojë këshillim dhe orientim për prindërit/kujdestarët mbi strategjitë e komunikimit në mjedisin familjar;
- Bashkëpunojë ngushtë me profesionistët e tjerë të qendrës për integrimin e ndërhyrjes logopedike në programet ditore;

4. Kërkesat e përgjithshme të kualifikimit

- Diplomë universitare në Logopedi ose në një fushë të afërt (sipas legjislacionit në fuqi);
- Licencë profesionale për ushtrimin e profesionit të Logopedit;



Fshati Prush, Komuna Vaqarr, Tirane-Albania
Mob: +355(0)682084945
E: info@helphthelife.org.al
W: www.helphthelife.org

- Përvojë pune me fëmijë dhe/ose të rinj me çrregullim të spektrit të autizmit dhe aftësi të kufizuara intelektuale (e dëshirueshme);
- Njohuri mbi zhvillimin e gjuhës dhe komunikimit, si dhe metodat e ndërhyrjes logopedike;
- Njohuri mbi standardet e shërbimeve sociale dhe rehabilituese.

5. Procedura e aplikimit

Kandidatët e interesuar, të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara në këto Terma Reference, ftohen të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm brenda afatit të përcaktuar, jo më vonë se data 30.01.2026, ora 17:00:

- Letër motivimi, ku të shpjegohet interesi për pozicionin dhe mënyra se si kandidati/ja i plotëson kriteret e kërkuara;
- Curriculum Vitae (CV) e detajuar dhe e përditësuar;
- Kopje e diplomës Bachelor dhe/ose Master, sipas kërkesës së pozicionit;
- Kopje e licencës për ushtrimin e profesionit, sipas kërkesës së pozicionit;
- Dokumente të tjera mbështetëse (certifikata trajnimesh, referenca pune, etj.), nëse aplikohen.
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore.

Dokumentet duhet të dorëzohen në adresën e email: info@helphthelife.org.al me subjekt : Aplikim per pune (duke specifikuar pozicionin e dëshiruar).

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen për fazat e mëtejshme të procesit të përzgjedhjes.